



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E TETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **16.08.2024 (e Premte)** në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, znj.Zejnepe Osmani, ndërsa mungoi znj.Zyrafete Rama. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, mirë se keni ardhur në mbledhjen e tetë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Matriali e keni marr me kohë, i kemi vetëm dy pika të rendit të ditës. Para se të hy në rend të ditës hapi diskutimin nëse ka ndonjë pyetje.

z.Illiri Zuka: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Në fshatin Trestenik ka qenë një fatkeqësi, u djegë një shtëpi, edhe pronari i asaj shtëpie është në gjendje shumë të rand ekonomike. Unë kisha lut që si legjislativ e si ekzekutiv me këshyrë mundësitë me i ndihmu. E di që ai është tu nejt në qiellin e hapur, se dje e kam vizitu. Ne si intitucione duhet me bë përpjekje me i ndimu, sepse është në gjendje shumë të rënd.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Gjatë mandatit sa kam qenë unë kemi pas edhe më herët edhe dy shpija të djegura. Nëse ka pas naj ndim prej kyetarit deri në 500 euro, po në kunend nuk ka ardh. Nëse vjen në kuvend duhet me ardh nga Drejtoria e Financave kërkesa me kod. Nëse na bjen Drejtoria e Financave ne mundem me e qitë në kuvend.

z.Jakup Demiri: Personi është vendos me një banesë në Viti, po gjendja ekonomik e tij është tepër e rand dhe po besoj që duhet me i ndimu, sepse e ka gjendjen e rand.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këshilli i fshatit së bashku me banorët me bë një kërkesë tek Drejtoria e Financave e ata me e pru në kuvend e ne e kalojmë. Faleminderit për kontributin! Materialin e keni marrë me kohë. Për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d i t e

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2.Informatë për aktivitetet dhe kontratat e realizuara të prokurimit në periudhën 6-mujore për vitin 2024.**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për rendin e ditës. Pasi që nuk ka e qes në votim për miratim rendin e ditës. Nga të gjith të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
Hapi debat per kete pikë. Nga të gjithë të pranishmi u miratu pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë e dytë të rendit të ditës kemi:

2. Informatë për aktivitetet dhe kontratat e realizuara të prokurimit në periudhën 6-mujore për vitin 2024

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Ju informatën e keni pranuar me kohë, në të cilën janë të përfshira informata për aktivitetet dhe kontratat e realizuara të prokurimit në periudhën 6-mujore për vitin 2024. Shënimet janë të gjitha ku e keni edhe tabelat me çmim. Për informata shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ilir Zuka: Fadil, përshendetje! Faleminderit për sjelljen e këtij raporti. Kam një pyetje: a keni pas problem këtë vit si vitet e kaluara me ankesa dhe me procedura të shpalljes së tenderave.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Jo, këtë vit nuk kemi pas problem, kemi pas ankesa po jo probleme si vitin e kaluar. I kemi dy landë në USHP që janë shku me ankesë: asfalti i rrugës për Vernakoll dhe rrugët rurale. Të dyja janë në procedurë të ankimit.

z.Jakup Demiri: Puna e hartes zonale, janë parapa 150 mijë euro.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Te harta zonale procedura është kry, është shpall fituesi, ama kontrata nuk është lidhë, kemi problem me kod, nuk e kanë caktu, tash mos po e gjajmë një kod, është një pakujdesi që kur e kanë bë procedurën e kan harru, mirëpo procedura është kry. E rëndësishme është mu bë sa me shpejtë. Kompania fitues është INS-i, është e vetmja kompani që ka apliku dhe është shpall fituese. Po e presim zotimin me e ba edhe me e lidhë kontratën.

z.Jakup Demiri: Janë edhe dy aktivitete me procedurën e negocuar. Çka bahet fjalë këtu. Te kontrata shtesa: sa është shtesa?

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Njëra është punë shtesë, edhe tjetra kontratë e lidhur nga ASHP-ja, e ne furnizohemi me kompjutera, edhe pse nuk i pasna shti të dhënat këtu, ama kjo është. E tek kontrata shtesë nuk del mbi 10%.

z.Iliri Zuka: Qetu që e ke ndërtimi i urës në Budrikë edhe Skifteraj. A është fjala që ka me u bë zgjerimi i urave apo çka është problemi.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Po këto janë zgjerimi i urave, kan mu bë dy kahshe. Ka dështu ky, sepse nuk kemi pas buxhet, kemi pak buxhet për këtë.

znj.Majlinda Shabani: Tek blerja e shërbimeve të konsulencës individuale për nevoja të projektit, po e shof që Kros Border është nda në tri lloto, janë tre emra: Mediana Bislimi, Arton Hjadari, Besim Imeri. Çfarë shërbime konsulente ofrojnë këta?

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: “Gros Border”, unë e di që gjithmonë e jep një projekt në bashkëpunim. Këto janë mjete që i jep Evropa, por ata kur e kanë lidh momerandumin kanë thanë financieri, menagjeri, e kjo Mediana është menagjere, Ariani e Besimi, njani është financier e njëri udheheq projektin. Ata e kanë pas kriter që me e zgjedh me prokurim, edhe ne e kemi bë me prokurim, e këta i pagujmë ne komuna për 24 muaj.

znj.Majlinda Shabani: Asfaltimi i rrugëve rurale në Komunën e Vitisë, 2 milion e 388 mijë. A është për krejt rrugicat që janë nënshkru për këtë vit mirëmbajtja verore e dimërore e rrugëve?

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Këto janë kontrata nga tani që do të vijnë. Tek mirëmbajtja e rrugëve e kemi kry. Këta nuk e di a është e shkume, është i njëjti operator që ka konkuru e ka fitu.

z.Ilir Zuka: Kohën e fundit kemi pas shumë problem me ndriçim publik. A janë kanë procedurat për mirëmbajtje, sepse kot ban ndriçim publik nëse nuk ka mirëmbajtje.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: E kemi trajtu edhe në zyre këtë me kryetarin e drejtorat, edhe kontrata që është e lidhur është shërbim e zhvendosje të poqave, se tani janë poqat eko. Kontrata është 10-vjeçare. Kemi probleme te dëmtimeve që nuk janë në mirëmbajtje. Nëse e then shtyllën, ai se ka përgjegjësinë me ardh me e ndreq. E tash jemi tu mendu me ba një kontratë tjetër e cila merret vetem me dëmet fizike, ku bëhen nga

faktori njeri. Ka raste që po i thejnë. Unë e kam pa me sy te mi, 6 shtylla jan të thyme, dëmtim fizik që nuk e parasheh kontrata.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tek pjesa e kontratave qeto që janë të nënshkruara nuk janë të publikuara. Në web të komunës duhet të publikohen. Në momentin që një kontratë përfundon, a vjen tek ju, a e dini ju që është përfundu, që me përfundu projekti? P.sh.: është një tretuar në Smirë, i cili ka nis para fushatës 2021. Ai kurr nuk është kry. Ai është problem me hec natën në këtë tretuar. Kanë kalu katër vite. Tash nuk ka kontratë katërvjeçare. Nëse një trotuar 400-500 metra mbete 4 vite pa u rregullu, a ka shumica e projekteve pranim teknik. Kemi pas projekt dyvjeçar e nuk është pranu puna ende. Ti e dinë p.sh.: kanalizimi në Smirë su krye me vjet: çka ka ndodhë me ta?

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Tretuari ka fillu edhe ka ngecë. Kemi pas problem me anën se cilën anë mu shtru. E kanë ndal punën, kemi pas problem aty, tash u rregullu. Ky problem duhet me u rregullu, duhet mu kry. Tek pranimi teknik që ishte pyetja. Po kanë pranim teknik. Ka disa probleme që i kemi, ama shumica kanë pranim teknik. Kanalizimi në Smirë nuk ka pranim teknik, nuk është përfundu asnjëhere.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, ju faleminderit për kontributin e dhënë. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
